

Nr. Prot. 005 / B /18

Nr. Regjistrir 35

RREGULLORE

PËR

'PAGESAT VJETORE PËR MBIKËQYRJE DHE TË DREJTËN E PËRDORIMIT TË RADIO FREKUENCAVE'

Kjo rregullore është nxjerr në bazë të nenit 3 paragrafi 1, neni 10 paragrafët 4) dhe 12), neni 45 paragrafët 1) dhe 2), neni 54 paragrafi 2) pika 2.6 dhe neni 57 paragrafët 1) dhe 2) të Ligjit për Komunikime Elektronike Nr. 04/L-109.

Neni 1

Qëllimi dhe Fushëveprimi i rregullores

- (1) Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i pagesave të rregullta vjetore për mbikëqyrje të shfrytëzimit të radio frekuencave dhe për të drejtën e përdorimit të radio frekuencave, si resurse të fundme kombëtare që menaxhohen nga Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (*tutje - ARKEP ose Autoritetit*) në gjithë territorin e Republikës së Kosovës.
- (2) Kjo rregullore vlen për të gjithë operatorët dhe ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike të autorizuar nga ARKEP, si dhe shfrytëzuesit tjerë të radio frekuencave në territorin e Republikës së Kosovës.

Neni 2

Definicionet

Të gjitha shprehjet e përdorura në këtë rregullore janë sikurse të përkufizuara me Ligjin për Komunikime Elektronike Nr. 04/L-109 kurse shprehjet tjera të përdorura do të jenë si në vazhdim:

- **Ndërmarrës** - është çdo person fizik dhe/ose juridik, ose një grup personash të bashkuar

në bazë të kontrollit apo të varësisë, të cilët janë të përfshirë në një veprimtari të komunikimeve elektronike në Republikën e Kosovës ose veprimet e të cilave, nëse realizohen, kanë ndikim ose qëllime, mund të kenë një ndikim në aktivitetin ekonomik në Republikën e Kosovës.

- **Operator** - është një ndërmarrës që ofron, ose që është i autorizuar të ofrojë një rrjet të komunikimeve elektronike ose faciliteteve shoqëruese.
- **Ofrues i shërbimeve të komunikimeve elektronike** - është një ndërmarrës, i cili është i autorizuar për ofrimin e shërbime të komunikimeve elektronike.
- **Pagesat për mbikëqyrje të shfrytëzimit të radio-frekuencave** - janë të përcaktuara si të hyra të Autoritetit të quajtura **pagesa për Autoritetin** (përfshire shërbimet - IMT, shërbimet me qasje brezgjera pa tel Braodband/Fixed Wireless Access - BWA/FWA dhe PAMR).
- **Pagesa për të drejtën e përdorimit të resurseve të komunikimeve elektronike /Radio frekuencave** - janë të përcaktuara si pagesa për buxhetin e shtetit.
- **Plani kombëtar i frekuencave** - është dokument që përcakton brezat frekuencore për shërbime të ndryshme dhe vendos kushtet bazë për ndarjen dhe dhënien e frekuencave, me qëllim të përdorimit efektiv të spektrit të radio frekuencave dhe shmangien e interferencave.
- **Radio interferencë** - është degradimi i performacës së pajisjeve dhe/ose mjeteve, radio-komunikimeve, ose radio-sistemeve për shkak të radio-çrregullimeve.
- **Resurse të komunikimeve elektronike** - janë radio-frekuencat (kanalet), numrat telefonikë dhe identifikuesit tjerë të rrjeteve të komunikimeve elektronike, të tilla si shenjat e radio-thirrjeve, resurset orbitale, duke përfshirë edhe pozitën në një orbitë gjeostacionare dhe burimet tjera të nevojshme për kryerjen e aktiviteteve të komunikimeve elektronike, për përdorimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike, ose radio-pajisjeve, apo pajisjeve fundore dhe për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike.
- **Spektri i radio frekuencave** - përfshinë valët elektromagnetike në diapazonin e frekuencave 9 KHz deri 3000 GHz, të cilat përhapen në ajër pa nevojën e linjave të veçanta.
- **Shërbim i komunikimeve elektronike** - është shërbimi që zakonisht ofrohet me pagesë, i cili përftohet, tërësisht ose pjesërisht, nga përcjellja e sinjaleve përmes rrjeteve të komunikimeve elektronike, që përfshin shërbimet e telekomunikacioneve dhe shërbimet e transmetimit në rrjetet e përdorura për transmetime radiotelevizive dhe në rrjetet e televizionit kabllor, por duke përjashtuar shërbimet, të cilat ofrojnë përmbajtje nëpërmjet rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike, ose që ushtrojnë kontroll redaksional ndaj përmbajtjes së ofruar për transmetimin, duke përdorur rrjetet ose

shërbimet e komunikimeve elektronike. Ai nuk përfshin shërbimet e shoqërisë së informacionit, të cilat nuk përbëhen, tërësisht ose pjesërisht, nga përcjellja e sinjaleve në rrjetet e komunikimeve elektronike.

- **Shërbimet e radio-komunikimeve** - janë veprimtaritë që mbulojnë komunikimet, që përfshijnë transmetimin, emetimin dhe marrjen e sinjaleve nëpërmjet radio-valëve.
- **Shfrytëzues** - është cilido që shfrytëzon ose kërkon të shfrytëzojë shërbime të komunikimeve elektronike, të disponueshme për publikun.

Neni 3 Metodologjia

Sipas kësaj rregullore metodologjia e aplikuar për përcaktimin e vlerës së pagesave të rregullta vjetore për shfrytëzim të spektrit radio frekuencorë është e bazuar në parimet vijuese:

- (1) Pagesa për brezin apo kanal frekuencor do të jetë në proporcion të drejtë me gjerësinë e kanalit apo brezit frekuencor të kërkuar dhe/ose të dhënë në shfrytëzim (*p.sh. pagesa e rregullt vjetore për kanal frekuencor me gjerësi 25 KHz për shërbimin PMR është dyfish më e lartë në raport me kanal frekuencor me gjerësi 12.5 kHz*).
- (2) Për brezet frekuencor për të cilat kërkesat për shfrytëzimin e radio-frekuencave janë më të vogla do të aplikohet pagesa stimuluese për shfrytëzimin e tyre.
- (3) Te shërbimet ku është përcaktuar koeficienti i popullsisë-KP shfrytëzimi i radio frekuencave në zonat me mbulueshmëri më të gjerë dhe numër më të madh të popullsisë do të paguhet më shumë sepse e redukton mundësinë e ri-shfrytëzimit të tyre.

Neni 4

Pagesat vjetore për mbikëqyrje dhe për të drejtën e përdorimit për shërbimin Radio Mobile (Lëvizshme) Private/Profesionale (PMR)

- (1) Private/Profesional Mobile Radio (PMR) është pjesë e shërbimit mobil tokësor dhe ofron komunikim të dyanshëm ndërmjet stacionit-eve fikse kontrolluese (base station) dhe një numri të njëjësive transmetuese-marrëse mobile (*stacionet portabël ose stacione të vendosura në automjete përkatëse*).
- (2) Brezat frekuencorë të alokuara për shërbimet PMR në territorin e Republikës së Kosovës janë të paraqitur në vijim;

- 2.1 146.0 -174.0 MHz (VHF)
- 2.2 406.1-430.0 MHz (UHF)
- 2.3 440.0-470.0 MHz (UHF)

- (3) ARKEP është përgjegjëse për menaxhimin e spektrit radio frekuencorë për te gjitha shërbimet e komunikimeve elektronike në brezat frekuencore për shërbime civile në pajtim me Planin Kombëtar të Radio Frekuencave (*njohur si; Tabela e Shpërndarjes dhe Shfrytëzimit të Spektrit Radio Frekuencorë*).
- (4) Ndërkaq gjerësia e kanalit në të dy brezat VHF dhe UHF për shërbimet PMR, zakonisht është 12.5 kHz, ndërsa kërkesa për shfrytëzimin e radio frekuencave me gjerësi të kanalit 25 kHz, aprovohet nga ARKEP, vetëm pas një shqyrtimi të veçantë.
- (5) Kushtet e përcaktimit të një tarife (pagesa) për shfrytëzimin e kanalit radio frekuencorë në brezat frekuencore për shërbimet PMR janë përcaktuar me dispozitat e Ligjit për Komunikime Elektronike dhe si të tilla janë dhënë në vijim:
- 5.1 Zona e mbulueshmërisë
 - 5.2 Numri i popullsisë në zonën e mbulueshmërisë
 - 5.3 KP- Koeficienti i Popullsisë
 - 5.4 Brezi frekuencorë dhe
 - 5.5 Gjerësia e brezit frekuencorë.

Brezi 146 - 174 MHz

- (6) Për sistemet radio komunikuese duplekse dhe gjysmë duplekse të shërbimit PMR (*ku numri i popullsisë është deri në 50 mijë banorë*) pagesa e rregullt vjetore për një kanal frekuencorë me gjerësi të brezit 12.5 KHz do të jetë sipas tabelës në vijim:

Zona e mbulimit	Stacion baze - Repetitor (Repetitor - Repetitor)	Stacion baze - Mobil (Repetitor - Mobil)
< 15 km	240.00 €	160.00 €
≥ 15 dhe < 40 km	260.00 €	200.00 €
≥ 40 dhe < 70 km	400.00 €	350.00 €
≥ 70 km (në tërë Kosovën)	500.00 €	450.00 €

- (7) Për sistemet identike me ato të pikës 6, të cilat shfrytëzohen në zonat me numër të popullsisë më të madh se pesëdhjetë mijë (50,000) banorë, pagesa e rregullt vjetore (*tarifat e mësipërme*) shumëzohen me koeficientin (KP) sipas tabelës në vijim;

Numri i Banorëve	Vlera a koeficientit-KP
50 deri 100 mijë	1.1
100 deri 250 mijë	1.3
Mbi 250 mijë	1.4

- (8) Për sistemet radio-komunikimi me gjerësi të kanalit 25 kHz, tarifat e cekura më lartë, në pikat 6) dhe 7) do të dyfishohen (*shumëzohen me 2*).

- (9) Për sistemet e radio-komunikimit simplekse zbatohen tarifat përkatëse sipas pikave 6) dhe 7) me një koeficient reduktues 0.5.

Brezi 440 - 470 MHz

- (10) Për këtë brez frekuencorë vlejné të gjitha tarifat e cekura në nenin 4 paragrafi 6 dhe nenin 4 paragrafi 7 të shumëzuara me koeficientin 0.85.

Neni 5

Pagesat vjetore për mbikëqyrje të shfrytëzimit të radio frekuencave për rrjetat e komunikimeve mobile (Lëvizshme) publike (GSM, DCS1800, IMT) në Republikën e Kosovës

- (1) Në përcaktimin e tarifave për brezin frekuencorë të rrjeteve mobile janë marrë parasysh këta faktor:
- 1.1 Brezi frekuencorëdhe
 - 1.2 Gjerësia e brezit apo kanalit frekuencorë.
- (2) Tabela në vijim paraqet kompensimet vjetore për brezin/kanalin frekuencorë të shërbimeve GSM/DCS dhe IMT për gjerësi të kanalit 1 x 1 kHz.

Brezi frekuencor	Tarifa vjetore (€)
(694 - 960) MHz	14.00
(1710 - 1900) MHz	10.675
(>1900) MHz	7.00

Neni 6

Pagesat vjetore për mbikëqyrje dhe për të drejtën e përdorimit të radio frekuencave për Linjat Fikse pikë-pikë (PTP , Point-to-Point)

- (1) Linjat fikse u referohemi gjithashtu si linja mikrovalore (*Radio Rele*) ose radio transmetues. Linjat fikse përdoren edhe nga rrjetat e mëdha të komunikimeve elektronike (*p.sh. operatorët mobil*), edhe nga operatorët e vegjël të cilët nuk ofrojnë shërbime të komunikimeve elektronike (*p.sh. bankat, kompanitë e shërbimeve të ndryshme etj.*).
- (2) Kalkulimet e tarifave vjetore për linjat fikse bazohen në disa faktorë, ku përfshihen:
- 2.1 Pagesat e rregullta vjetore, janë më të larta për brezat e ulëta më të ngarkuara,
 - 2.2 Gjerësia e brezit.

- (3) Brezi frekuencore prej 1-10 GHz, tabela në vijim paraqet pagesat e rregullta vjetore sipas gjerësisë të kanalit frekuencorë për linjat mikrovalore PTP për brezin frekuencorë 1-10 GHz

Gjerësia e kanalit frekuencorë (për çdo bartës një kahesh)	Tarifa vjetore (€)
≤ 0.5 MHz	75.00
> 0.5 MHz dhe ≤ 2 MHz	150.00
> 2 MHz dhe ≤ 7 MHz	300.00
> 7MHz dhe ≤ 15 MHz	500.00
> 15 MHz dhe ≤ 30 MHz	1,000.00
> 30 MHz dhe ≤56 MHz	1,500.00
>56 MHz dhe ≤ 80 MHz	2,250.00
>80 MHz	3,250.00

Brezi frekuencore prej 10 deri 15.35 GHz

Për këtë brez frekuencorë zbatohen pagesat e rregullta vjetore të cekura në pikën 3) të këtij neni të shumëzuara me një koeficient reduktimi 0,8.

Tabela në vijim paraqitur pagesat e rregullta vjetore për këtë brez.

Gjerësia e kanalit frekuencorë (për çdo bartës një kahesh)	Tarifa vjetore (€)
≤ 2 MHz	120.00
> 2 MHz dhe ≤ 7 MHz	240.00
> 7MHz dhe ≤ 15 MHz	400.00
> 15 MHz dhe ≤ 30 MHz	800.00
> 30 MHz dhe ≤56 MHz	1200.00
> 56 MHz dhe ≤80 MHz	1,800.00
> 80 MHz	2,600.00

Brezi frekuencorë prej 15.35 -22 GHz

Për këtë brez frekuencorë zbatohen pagesat e rregullta vjetore e cekura në pikën 3) të këtij neni të shumëzuara me një koeficientin e reduktimi 0,6.

Gjerësia e kanalit frekuencorë (për çdo bartës një kahesh)	Tarifa vjetore (€)
≤ 2 MHz	90.00
> 2 MHz dhe ≤ 7 MHz	180.00
> 7MHz dhe ≤ 15 MHz	300.00
> 15 MHz dhe ≤ 30 MHz	600.00

> 30 MHz dhe \leq 56 MHz	900.00
> 56 MHz dhe \leq 80 MHz	1,350.00
> 80 MHz	1,950.00

Brezi frekuencore mbi 22-30 GHz

Për këtë brez frekuencore zbatohen pagesat e rregullta vjetore e cekura në pikën 3) të këtij neni të shumëzuara me koeficientin e reduktimit 0,5.

Gjerësia e kanalit frekuencorë (për çdo bartës një kahesh)	Tarifa vjetore (€)
\leq 2 MHz	75.00
> 2 MHz dhe \leq 7 MHz	150.00
> 7MHz dhe \leq 15 MHz	250.00
> 15 MHz dhe \leq 30 MHz	500.00
> 30 MHz dhe \leq 56 MHz	750.00
> 56 MHz dhe \leq 80 MHz	1,125.00
> 80 MHz	1,625.00

Brezi frekuencor mbi 30 GHz (\geq 30 GHz)

Për këtë brez frekuencorë pagesat e rregullta vjetore e propozuara në pikën 3) të këtij neni shumëzohen me koeficientin e reduktimit 0.3.

Gjerësia e kanalit frekuencorë (për çdo bartës një kahesh)	Tarifa vjetore (€)
\leq 2 MHz	45.00
> 2 MHz dhe \leq 7 MHz	90.00
> 7MHz dhe \leq 15 MHz	150.00
> 15 MHz dhe \leq 30 MHz	300.00
> 30 MHz dhe \leq 56 MHz	450.00
> 56 MHz dhe \leq 80 MHz	675.00
> 80 MHz	975.00

Neni 7

Pagesat vjetore për mbikëqyrje dhe për të drejtën e përdorimit të radio frekuencave për Shërbimet satelitore

(1) Llogaritjet e pagesave të rregullta vjetore për shërbimet fikse satelitore bazohen në disa faktorë, ku përfshihen:

- 1.1 Lloji i pajisjes dhe
- 1.2 Gjerësia e brezit frekuencorë

(2) Sipas kësaj Rregullore të gjithë operatorët e shërbimeve VSAT të cilët nuk ofrojnë shërbime për palën e tretë, do lirohen nga pagesat e rregullta vjetore për shfrytëzim të frekuencave, nëse pajisjet e tyre i plotësojnë kushtet e mëposhtme:

2.1 Fuqia e transmetuesit nuk do të jetë më e lartë se 2 W, dhe

2.2 EIRP nuk do të jetë më e lartë se 50 dBW

(3) Në qoftë se nuk plotësohen kushtet e mësipërme, atëherë shfrytëzuesit e frekuencave satelitore, do të ngarkohen me pagesa të rregullta vjetore sipas kushteve të paraqitura në tabelën e mëposhtme:

Tabela në vijim tregon pagesat e rregullta vjetore për shërbimet fikse satelitore;

		Përshkrimi	Tarifa vjetore (€)
1		Stacioni Fiks tokësor (i përhershëm)	
	a)	Me gjerësi të brezit frekuencor deri në 0.5 MHz	250.00
	b)	Me gjerësi të brezit frekuencor deri në 1 MHz	500.00
	c)	Me gjerësi të brezit frekuencor deri në 2 MHz	1,000.00
	d)	Me gjerësi të brezit frekuencor mbi 2 MHz	2,000.00
2		Stacioni Tokësor VSAT	
	a)	Me gjerësi të brezit frekuencor deri në 0.5 MHz	250.00
	b)	Me gjerësi të brezit frekuencor deri në 1 MHz	500.00
	c)	Me gjerësi të brezit frekuencor mbi 1 MHz	1,000.00
3		Stacion portativ VSAT	
	a)	Me gjerësi të brezit frekuencor deri në 1 MHz	200.00
	b)	Me gjerësi të brezit frekuencor mbi 1 MHz	400.00
4		Stacion tokësor të transportueshem SNG(Satellite News Gathering)	3,000.00

(4) Pagesat vjetore për mbikëqyrje dhe për të drejtën e përdorimit të radio frekuencave për shërbimin CGC (Complementary Ground Component - Komponentët tokësore komplementare) për brezat (1980 - 2010) MHz dhe (2170 - 2290) MHz sipas ECC/REC (10)01 do të jetë:

- 200 € për 1 MHz.

4.1) Shërbimi CGC i përket sistemeve satelitore mobile, që shfrytëzon stacione tokësore (repetitor) të vendosura në vende fikse për të përmirësuar shfrytëzimin e shërbimit satelitor mobil, duke e përforcuar nivelin e sinjalit në zonat të caktuara gjeografike, ku nuk mund të sigurohet kualitet i duhur i komunikimit me një ose më shumë stacione hapësinore.

Neni 8

Pagesat vjetore për mbikëqyrje dhe për të drejtën e përdorimit të radio frekuencave për Shërbimet TETRA

Faqe 8 nga 12

- (1) Përcaktimi i pagesave të rregullta vjetore për shfrytëzimin e spektrit radio frekuencorë në brezat e frekuencës 380 - 400 MHz, për shërbimet TETRA dhe gjerësi të kanalit prej (2 x 25 kHz), do të bëhet duke marrë parasysh këta parametra dhe shfrytëzuar shprehjet:

$$T = N \times P$$

ku,

T - tarifa vjetore,

N - çmimi njësi me vlerë 200.00 Euro,

P - paraqet koeficientin (KP) për numrin e popullatës në hapësirën ku ofrohet shërbimi, dhe vlera e

tij është::

- 1 - për < 50,000 banorë;
- 1.2 - për 50,000 deri 100,000 banorë;
- 1.5 - për 100,000 deri 250,000 banorë dhe
- 2 - për > 250,000 banorë.

Këto vlera aplikohen vetëm për rastet kur operatorët janë rajonal.

Nëse operatorët dëshirojnë përdorim ekskluziv në gjithë territorin e Republikës së Kosovës, atëherë vlera e P duhet të jetë 3.

Duke marrë parasysh kushtet e mësipërme, përcaktimi i pagesës së rregullt vjetore për gjerësi të kanalit të frekuencës prej (2 x 25) kHz, bëhet sipas tabelës së më poshtme:

Numri i banorëve	TETRA - (380 - 400) MHz (Euro)
< 50,000	200.00
50,000 - 100,000	240.00
100,000 - 250,000	300.00
> 250,000	400.00
Në gjithë Kosovën	600.00

Neni 9

Pagesat vjetore për mbikëqyrje të shfrytëzimit të radio frekuencave për Shërbimet PAMR

- 1) Përcaktimi i pagesave të rregullta vjetore për shfrytëzimin e spektrit të radio frekuencës në brezat e frekuencës 410 - 430 MHz, për shërbimet PAMR (përfshirë edhe

teknologjinë CDMA) dhe gjerësi të kanalit prej (2 x 1.25 MHz), do të bëhet duke marrë parasysh këta parametra dhe shfrytëzuar shprehjet:

$$T = N \times P$$

ku,

T - tarifa vjetore,

N - çmimi njësi me vlerë 1,500.00 Euro,

P - paraqet koeficientin (KP) për numrin e popullsisë në hapësirën ku ofrohet shërbimi dhe vlera e tij është;

1 - për < 50,000 banorë;

1.2 - për 50,000 deri 100,000 banorë;

1.5 - për 100,000 deri 250,000 banorë dhe

2 - për > 250,000 banorë.

1.1) Këto vlera aplikohen vetëm për rastet kur operatorët janë rajonal.

- 2) Nëse operatorët dëshirojnë përdorim ekskluziv në gjithë territorin e Republikës së Kosovës, atëherë vlera e P duhet të jetë 3.
- 3) Duke marrë parasysh kushtet e mësipërme, përcaktimi i pagesës së rregullt vjetore për gjerësi të kanalit të frekuencës prej (2 x 1.25 MHz), bëhet sipas tabelës së më poshtme:

Numri i banorëve	PAMR - (410 - 430) MHz (Euro)
< 50,000	1,500.00
50,000 - 100,000	1,800.00
100,000 - 250,000	2,250.00
> 250,000	3,000.00
Në gjithë Kosovën	4,500.00

Neni 10

Pagesat vjetore për mbikëqyrje të shfrytëzimit të radio frekuencave për Shërbimet brez gjëra fikse FWA/BWA (Fixed Wireless Access/Broadband Wireless Access)

- (1) Përcaktimi i pagesave të rregullta vjetore për shfrytëzimin e spektrit të frekuencës për shërbimet brezë gjëra fikse, FWA/BWA, do të bëhet duke marrë parasysh këta parametra:
 - 1.1 Brezi i frekuencës - Tarifat janë më të larta për brezat e frekuencës në pozicione më të ultë të spektrit RF,
 - 1.2 Gjerësia e brezit të frekuencës,

1.3 Numri i popullsisë – Vetëm në rastin e operatorëve rajonal

Përcaktimi i tarifave vjetore për këto shërbime do të bëhet duke shfrytëzuar shprehjet:

$$T = N \times B \times F \times P$$

ku,

T – tarifa vjetore,

N – çmimi njësi me vlerë 240.00 Euro,

B – gjerësia e brezit të frekuencës (në MHz) prej 1 x 1 MHz,

F – frekuenca bartëse - pozicioni në spektrin RF, vlera e tij është:

1 - për (3.4 – 3.8) GHz,

0.6 - për (10.15 – 10.3) GHz; (10.5 – 10.65) GHz,

0.3 - për (24.5 - 26.5) GHz; (27.5 - 29.5) GHz,

0.2 - për > 30 GHz.

P – paraqet koeficienti (KP) për numrin e popullsisë në hapësirën ku ofrohet shërbimi, dhe vlera e tij është:

1 - për < 50,000 banorë,

1.1- për 50,000 deri 100,000 banorë,

1.2 - për 100,000 deri 250,000 banorë dhe

1.3 - për > 250,000 banorë.

1.4) Këto vlera aplikohen vetëm për rastet kur operatorët janë rajonal, përndryshe nëse operatori ofron shërbime në gjithë territorin e Republikës së Kosovës, vlera e tij do të jetë 1.5.

2) Duke marrë parasysh kushtet e mësipërme, përcaktimi i tarifave vjetore për gjerësi të kanalit të frekuencës prej (1 x 1 MHz), bëhet sipas tabelës së më poshtme:

Numri i banorëve	(3.4 – 3.8) GHz (Euro)	(10.15 – 10.3) GHz (10.5 – 10.65) GHz (Euro)	(24.5 – 26.5) GHz (27.5 – 29.5) GHz (Euro)	> 30 GHz (Euro) (duke përfshirë shërbimin PMP)
< 50,000	240.00	144.00	72.00	48
50,000 - 100,000	264.00	158.40	79.20	52.8
100,000 - 250,000	288.00	172.80	86.40	57.6
> 250,000	312.00	187.20	93.60	62.4
Për gjithë Kosovën	360.00	216.00	108.00	72

Neni 11

Pagesat vjetore për mbikëqyrje dhe për të drejtën e përdorimit të radio frekuencave për Shërbimet e aeronautikës

(1) Përcaktimi i pagesave të rregullta vjetore për shërbimet e aeronautikës do të behet vetëm për llojin e pajisjeve që shfrytëzohen:

- | | | |
|-----|---|---------------|
| 1.1 | Radio stacionet tokësore; | 80.00 €/njësi |
| 1.2 | Radarët dhe pajisjet e radionavigacionit aeronautik, identifikim, pozicionim, dhe sinjalizim; | 20.00 €/njësi |

Neni 12

Pagesat vjetore për mbikëqyrje dhe për të drejtën e përdorimit të radio frekuencave për brezat e frekuencës HF

(1) Përcaktimi i pagesave të rregullta vjetore për shfrytëzimin e spektrit të frekuencës në brezat e frekuencës HF (3 - 30) MHz, shërbimet fikse dhe të lëvizshme dhe gjerësi të kanalit prej 12.5 KHz, do të bëhet në këtë mënyrë:

- | | |
|-----|-------------------------------------|
| 1.1 | 150.00 € - Semi-dupleks ose Dupleks |
| 1.2 | 75.00 € - Simpleks |

Neni 14

Hyrja në Fuqi

- 1) Kjo rregullore ka efekt juridik nga 1 Janari 2018.
- 2) Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet Rregullorja Nr. 17 për Pagesat për Shfrytëzimin e Radio Frekuencave (*nr.prot. 082/B/11; dt. 20/12/12*).

Prishtinë, 19/ 01 /2018

Kreshnik Gashi

Kryetar i Bordit, ARKEP